



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET**  
**YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS**  
**DHE**  
**KOMUNËS SË LIPJANIT**

Youth Association for Human Rights dhe Komuna e Lipjanit (referuar si Palë)

YAHR është duke e realizuar projektin : **“Institucione transparente dhe llogaridhënëse në nivel lokal”** të përkrahur nga Aktiviteti i USAID për Bashkëpunim në Komunitet.

Projekti ka për qëllim: *Demokratizim të institucioneve lokale dhe mobilizim më efektiv të qytetarëve për t’i mbajtur të zgjedhurit e tyre në llogari.*

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje për të bashkëpunuar në bazë të një partneriteti me qëllim të ngritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit komunal për vitet 2021/23.

Duke marrë në konsideratë që përpjekjet dhe eksperiencat e secilës palë të jenë në mënyrë të ndërsjellët përfituese;

Duke marrë në konsideratë promovimin dhe integritetin e mirëqeniejes;

Palët bien dakord si më poshtë:

**Neni 1.**  
**Qëllimi**

Palët të jenë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira, për mes:

- a. Shkëmbim të eksperiencave,
- b. Përfshirje dhe angazhimin e shoqërisë civile në bashkëpunim me në aktivitete lokale në komunën e Lipjanit në aspektin e ngritjes së pjesëmarrjes qytetare në procesin e hartimit të buxhetit komunal,

**Neni 2.**  
**Fusha e zbatimit**

Me qëllimi zbatimin me korrektësi të kësaj Marrëveshje, Palët angazhohen:

- a. Të realizojnë aktivitete të përbashkëta për përfshirjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore,
- b. Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunës në tryezat e organizuara nga YAHR-i në nivel lokal,
- c. Përkrahje në fushatën për ngritjen e pjesëmarrjes qytetare në dëgjimet buxhetore
- d. Inkorporimin e kërkesave të qytetarëve në buxhetin komunal për vitet 2021/23.

**Neni 3**  
**Format tjera bashkëpunimi**

- a. Palët angazhohen të mundësojnë këshillime, informacione teknike dhe dokumentim të informacionit përmes kanaleve të komunikimit formal,
- b. Të realizojnë kërkime të përbashkëta në çështje me interes të përbashkët;

**Neni 4**  
**Komunikimi**

Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin e memorandumit dhe për përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara në memorandum.

**Neni 5.**

Memorandumi mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve.

**Neni 6.**

Memorandumi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy palët.

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër.

Memorandumi mbahet në dy kopje origjinale.

Data: \_\_\_\_\_

Vendi \_\_\_\_\_

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR



Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit

